

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRYEMINISTRIT - URBAN PREMIERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nr. Prot: 013	Nr. Prot: 1727
Dato: 19.04.2018	Dato: 19.04.2018

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRYEMINISTRIT - URBAN PREMIERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nr. Prot: 01	Nr. Prot: 1059/32
Dato: - 19 -	Dato: 19/04/2018

Për: Kryeministrin e Republikës së Kosovës z.Ramush Haradinaj

Nga: Zv.Ministri i Arsimit, Shkenës dhe Teknologjisë z.Artan Berisha

Lënda: Raporti për 20.02.2018 – 10.04.2018

Datë: 18.04.2018

20.02.2018 – Sot me 20.02.2018 jam emëruar Zv.Ministër i MASHT. Kryesia e PLE-së në Klinë duke u bazuar në vendimin e 14 maj 2017 që vota të jetë fuqi, morri vendim për emërtimin tim për Zv.Ministër. Pozita e Zv.Ministrit të MASHT është privilegj për mua, mirpo njëkohësisht edhe përgjegjësi shumë e madhe, pasi që fusha e arsimit ka një rëndësi shumë të madhe për komunitetin tone, sepse vetëm me një fushë të mire të arsimit mund të kemi përfaqësim më të mirë.

23.02.2018 – Takim me Sekretarin e përgjithshëm të MASHT z.Ekrem Kastrati. Qëllimi takimit ishte informues dhe si mund të kemi ndikim në interesin e të rinjëve tanë në fushën e Arsimit. Me z.Kastrati biseduam shumë qështje për Arsim dhe u dakorduam që të kemi bashkpunim të përbashkët. Z.Kastrati shprehu gadishmëri për bashkpunim.

28.02.2018 – Takim me Drejtorin e Përgjithshëm të Qendrës Studentore z.Fatmir Sfishta dhe me Drejtorin e Konvikteve në Prishtinë z.Isak Beha.

Duke marrë parasysh që shumë student/e pikërisht për shkak të mosmundësis të qëndrimit në banesa private, obligohen që mos të aplikojnë fare për tu regjistruar në studime Universitare, sot takimi me z.Sfishta dhe z.Beha ishte I domosdoshëm. Nga sot pas dakordimit me z.Sfishta dhe z.Beha të gjithë studentët e komunitetit Egjiptian do të mundohemi të ju bëjmë të mundshme regjistrimin në Konvikt dhe Menze.

02.03.2018 – Sot i shoqëruar nga Deputeti z.Veton Berisha, Kryetari i Degës së PLE-së në Prizren z.Gzim Morina dhe nënkryetari z.Shkelzen Kopriva takuam Kryetarin e Komunës së Prizrenit z.Mytaher Haskuka.

Takimi ishte aranzhuar me qëllim të njhjes më për së afërmi me Kryetarin z.Haskukame gjendjen dhe nevojat e komunitetit Egjiptian dhe komuniteteve tjera që jetojnë dhe veprojnë në këtë komun. Bashkarisht u dakorduam për disa veprime të përbashkëta me qëllim të përfitimeve të sa me shumë projekteve dhe komuniteti të jetë sa më I përfaqësuar.

Kryetari z.Haskuka premtoj gadishmërin dhe angazhimin e tij që komuniteti Egjiptian në komunën e Prizrenit të trajtohet me prioritet duke ndërmarr secilin veprim të mundshëm.

07.03.2018 – I shoqëruar nga Asistenti z.Isuf Berisha takuam Drejtorin për Punë Sociale z.Gjon Lulin. Qëllimi i takimit ishte skema për përfitimin e socialit në Komunën e Gjakovës. Pjesa më e ndieshme është skema programore e përfitimit të ndihmës sociale.

U informuam nga afër për familjet përfituese nga skema sociale, si dhe kërkua rishqyrtimin e disa familjeve të cilave ju refuzuan ndihma sociale. Drejtori z.Luli shprehu gadishmërin për bashkëpunim dhe përkrahje në mënyr që të ndihmohen familjet e nevojshme.

08.03.2018 – Së bashku me znjsh.Violeta Thaqi – Kordinatore për Banim nga Vorae vizituam disa familje në Gjakovë.

Qëllimi i takimit ishte ti shofim nga afër familjet të cilat vërshimet i rrezikuan dhe të informohemi nga afër me problemet e tyre. Me Kordinatoren znjsh.Thaqi diskutuam se si mund të ndihmojmë këto familje dhe u dakorduam që shumë shpejtë të takohemi me Kryetarin e Komunës së Gjakovës z.Ardian Gjini dhe të arrijmë deri te një zgjidhje për ti ndihmuar disa familje.

08.03.2018 – Pasi i vizitova disa familje në Komunën e Gjakovës, të cilat janë rrezikuar nga vërshimet, takova z.Armend Behlulin – Drejtor i Zyrës për Komunitete dhe Kthim në Gjakovë, duke i treguar mbi situatën dhe gjendjen në të cilën jetojnë këto familje. Z.Behluli shprehu keqardhje për familjet që janë përfshirë nga vërshimet dhe u dakorduam që të shiqohet mundësia se si mund të i ndihmojmë familjet e lartëpërmendura.

12.03.2018 – Së bashku me Asistentin z.Isuf Berisha jemi takuar me znj.Kumrije Gagica – Udhëheqëse e Divizionit për Njohje dhe Barazvlerë dhe znj.Qamile Sinanaj – Udhëheqëse e Divizionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Me znj.Gagica diskutuam për studentët të cilët përfundojnë studimet jashtë vendit dhe nostifikimi i diplomave të tyre në MASHT, u dakorduam për mundësin e përsheptimit të procedurës.

Znj.Sinanaj gjithashtu takim shumë i rëndësishëm, ku diskutuam dhe u dakorduam për mundësin e studimeve jashtë vendit dhe përfitimi i bursave.

13.03.2018 – sot në cilësi të Sekretarit të Përgjithshëm të PLE-së u takova me z.Albert Krasniqi – Menaxher I Projektit për Përkrahje të Hulumtimeve Parlamentare nga KDI.

Diskutuam rrugëtimin drejt një përfaqësimi më të mirë të PLE-së. Gjithashtu një nga pikat e diskutimit ishte se sit ë fuqizohën të rinjët dhe si të kemi përfaqësim të gruas dhe vetëdiesim më te mire ne përgjithësi. U dakordua që të kemi trajnime dhe tryeza në mënyrë që të informohen se si të gjejme rrugën drejt përfitimit të mundësive në fusha të ndryshme.

13.03.2018 – Takim me Rektorin e UP-së Prof.Dr.Marjan Dema. Sot I shoqëruar nga Depiteti z.Veton Berisha dhe Asistenti im z.Isuf Berisha takuam rektorin e UP-së z.Dema. Q ëllimi I takimit ishte shumë I rëndësishëm sepse biseduam dhe u dakordua për shumë qështje sa I përket fushës së Arsimit. Kërkuam Implementimin e Udhëzimit Administrativ për regjistrimin e studentëve nga radhët e komunitetit, gjithashtu u dakordua për të gjetur një formë legale që të mos keqpërdoren vendet e rezervuara për komunitete. Rektori I UP-së z.Dema shprehu gadishmëri për bashkëpunim dhe shprehu kënaqësi për interesimin tonë të hershëm.

13.03.2018 -- Takim I Kryesis me përfaqësues të lagjeve dhe fshatërave në Gjakovë. Në cilësi të Kryetarit të PLE-së Dega në Gjakovë takova Kryesin dhe përfaqësuesit e lagjeve dhe fshatërave.

Agenda ishte:

- 1.Miratimi I agjendës
- 2.Informim rreth pozitës së Z.Ministrit të MASHT
- 3.Diskutim për takimin me Kryetarin e Komunës së Gjakovës z.Ardian Gjini
- 4.Shpërndarja e ndihmave për familjet e varfura në Gjakovë
- 5.Identifikimi I familjeve të varfura dhe fëmijëve jetim
- 6.Të ndryshme

21.03.2018 – Takim me znj.Fadile Dyla – Drejtoresh e Departamentit për Infrastrukturë të Ndërtesave Arsimore, ku biseduam për shumë qështje e sido,mos për mundësin e ndërtimit dhe renovimit të shkollave në Republikën e Kosovës. Kërkesat janë shumë të mëdha nga fshatëra dhe qytete, mirpo sot kërkova të shiqohet mundësia që në vazhdimësi të vizitohet Shkolla Fillore “Haxhi Hoti” në Rogovë dhe të vlersohet objekti shkollor. Me znj.Dyla u dakordua që të kemi bashkpunim për projekte në të ardhmën.

25.03.2018 – PLE-ja përmes projektit të Qeveris së Republikës së Kosovës ndihmon 110 familje me nevojë me dru, miell dhe pako ushqimore në Gjakovë. PLE edhe kësaj radhe është munduar të l del në ndihmë familjeve nevojtare, në kuadër të këtij aktiviteti përfitues ishin 7 lagje dhe 7 fshatëra, përfaqësuesit tonë janë munduar ti përfshijnë familjet të cilat kan pasur më shumë nevoj.

29.03.2018 – Së bashku me stafin tim, i shoqëruar edhe nga Deputeti z.Veton Berisha dhe Zv.Ministri I MAPL z.Bashkim Krasniqi ishim në pejë dhe përcollëm z.Kujtim Haziraj, I cili përmes mbështetjes tone ne procedurat e Ministris së Shëndetsis u dërgua në Spitalin Amerikan në Tiranë për transplant të veshkës.

03.04.2018 – Takim me prindër në Fush Kosovë. Sot I shoqëruar nga Asistenti im z.Isuf Berisha u takuam dhe bashkëbiseduam me disa prindër të nxënësve në Fush Kosovë.

Qëllimi I takimit ishte të motivohen fëmijët për ti vijuar dhe mos ndërpre procesin mësimor. Gjithashtu prindërit shpalosën problemet, vështirësit dhe brengat e tyre. U dakorduam se shumë shpejtë do të takona me Drejtorin e Arsimit në Fush Kosovë dhe me Drejtor të shkollave.

04.04.2018 – Takim me Këshilltarin Ligjor dhe Udhëheqësin e Financave nga Institucioni I Avokatit të Popullit.

Sot kisha takim me z.Besart Elshani – Këshilltar Ligjor në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe z.Beqir Musliu – Udhëheqës I Financave në Institucionin e Avokatit të Popullit. Qëllimi I takimit ishte të informohemi më shumë për punën dhe aktivitetet që kanë në kuadër të MASHT, gjithashtu për punën dhe përkushtimin e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Me z.Elshani dhe z.Musliu u dakorduam të kemi bashkëpunim në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

05.04.2018 – Takim me Ministrin e MASHT z.SyqiriBytyqi. Qëllimi I takimit kishte shumë rëndësi, pasi që diskutuam shumë gjëra rreth fushës së arsimit, regjistrimit të studentëve, bursa për student dhe shkolla të mesme.

Gjithashtu biseduam për infrastrukturën e objekteve shkollore, në veqanti për Shkollën Fillore "Haxhi Hoti" në Rogovë, Gjakovë dhe u dakorduam që së shpejti së bashku me Ministrin z.Bytyqi ta vizitojmë Shkollën "Haxhi Hoti" dhe Rogovën në përgjithësi.

05.04.2018 – Takim me Znj.Nazan Safqi – Udhëheqëse e Divizionit për Arsimin e Komuniteteve.

Nga Znj.Safqi kërkova të më informoj për shtrirjen e komuniteteve në fushën e Arsimit, gjithashtu u dakordua që së bashku të gjitha proceset në kuadër të fushës së Arsimit ti shtyjme përpara.

06.04.2018 – Në cilësi të **Zv.Ministrit të MASHT** isha në Restaurant “**Nafron Exclusive**” në Prizren për Ditën Ndërkombëtare të Romëve.

Përfaqësova Ministrin e MASHT dhe Partin Liberale Egjiptiane, i'u urova Ditën Ndërkombëtare të Romëve.

Me respekt,

Artan Berisha



Zv.Ministër i MASHT